



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2018

V E N D I M

Nr. 11, Datë 10 / 01 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me nr.162, datë 19.12.2017, të znj.L. G, kundër Korporatës Elektroenergetike Shqiptare sh.a¹; me objekt pretendimin për diskriminim “*për shkak të gjendjes arsimore*” dhe “*të bindjeve politike*”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

KONSTATOI:

Referuar deklarimeve të subjektit ankues, znj.L. G, rezulton se me shkresën me nr.158 prot., datë 09.01.2006 ajo ka lidhur marrëdhëniet e punës me KESH sh.a, në detyrën “Teknik specialist”, pranë Zyrës së Shërbimeve/Departamenti i Burimeve Njerëzore.

Me shkresën me nr.5287 prot., datë 28.04.2006 është emëruar në pozicionin e punës “Shefe zyre”, në Njësinë Organizative pranë Sektorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Pas përfundimit të kohës së provës, ankuesja ka lidhur kontratë pune me afat të pacaktuar me KESH sh.a.

Në kuadër të ristrukturimit të korporatës, me shkresën me nr.1197 prot., datë 18.02.2014 znj.G i është komunikuar ndryshimi i vendit të punës duke kaluar në Njësinë Organizative, Departamenti Ekonomik/Sektorit të Detyrimeve të Prapambetura, duke mos i ndryshuar funksioni, klasifikimi dhe as niveli i pagës.

Ankuesja pretendon se me ndryshimet politike në vend dhe me ndryshimin e menaxhimit të KESH sh.a, ndaj personit të saj ka nisur dhe diskriminimi në procedurën e largimit të saj nga

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KESH sh.a.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

puna, nga ana e drejtuesve të kësaj Korporate. Ajo e argumenton si më poshtëcitohet: “...Gjatë gjithë kohës që kam qenë e punësuar pranë KESH sh.a dhe deri në fillimin e makinacionit diskriminues të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, nuk më është bërë asnjë vërejtje për punën. Vlerësimet për arritjet individuale në punë si dhe sjellja e përgjithshme kanë qenë maksimale. Kam përmbushur me seriozitet detyrën funksionale dhe çdo detyrë tjetër që më është ngarkuar”.

Ankuesja shprehet se ka bindjen se ajo është diskriminuar për shkak të bindjeve të saj politike (si gruaja e një ish-funksionari të lartë të shtetit) dhe të gjendjes së saj arsimore, pasi në mënyrë të papritur dhe të pabazuar në shkaqe të provuara, brenda një kohe të shkurtër pas ndryshimit të pozicionit të saj në departamentin e ri (pas ristrukturimit) i është dhënë masa disiplinore për mospërmbushje të përsëritur të detyrave.

Shkresën me nr.2581/2 prot., datë 17.04.2014 për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje” të KESH sh.a ankuesja e ka kundërshtuar me datë 25.04.2014³, duke parashtruar dhe argumentat se përse kjo masë është e padrejtë dhe pa shkak të ligjshëm, në kundërshtim flagrant me nenin 63 të kontratës kolektive të punës.

Me shkresën me nr.2581/4 prot., datë 02.05.2014 KESH sh.a ka lënë në fuqi masën disiplinore “Vërejtje” ndaj znj.G. Ndërkaq, subjekti ankues informon se me datë 12.10.2015 punonjës të stafit drejtues të KESH sh.a u paraqitën në Sektorin ku ajo punonte dhe urdhëruan dëbimin nga puna të ankueses dhe punojësve të tjerë, duke i urdhëruar të mos paraqiteshin më në punë për arsye se me strukturën e re nuk kishin më vend pune pranë kësaj Korporate.

Me datë 14.10.2015, përmes shkresës me nr. 8859 prot., ankueses i është komunikuar njoftimi mbi fillimin e bisedimeve për zgjidhjen e kontratës së punës.

E ndodhur në kushte jo të mira shëndetësore dhe të përkeqësuar nga situata e mësipërme me KESH sh.a, ankuesja ka qenë me raport mjekësor për paaftësi të përkohëshme në punë. Pas përfundimit të raportit mjekësor është paraqitur në punë dhe i është komunikuar shkresa me nr.8859/3 prot., datë 19.11.2015 e Administratorit të KESH sh.a “Vendim përfundimtar për zgjidhjen e kontratës së punës”⁴.

Ankuesja shprehet se zgjidhjen e kontratës së saj të punës, KESH sh a e ka bërë duke sjellë si argument Vendimin e Këshillit Mbikqyrës nr.16/2015 “Për ristrukturimin dhe miratimin e strukturës organizative dhe numrit të përgjithshëm të punonjësve të KESH sh a”. Lidhur me këtë znj.G shprehet se: “...struktura organizative e KESH sh.a ka ndryshuar me pakësimin e numrit të punonjësve dhe njëkohësisht me ndryshimin e emërimit të Sektorit të Detyrimeve të Prapambetura në Sektori i Administrimit të Aseteve, pa dhënë asnjë motivacion apo shkak justifikues. Ndryshimi i strukturës nuk u bë publik për të gjithë punonjësit”.

³Shkresa me nr.2581/3 prot., datë 25.04.2014.

⁴ Ndërprerja e marrëdhënieve financiare është bërë me datë 01.03.2016.

Ankuesja shprehet se bazuar tek performanca saj në punë, arsimi dhe vjetërsia në punë ajo nuk mund të zëvendësohej nga punonjës të tjerë dhe prandaj ka bindjen që kjo ka ndodhur vetëm se ajo kishte bindje politike të ndryshme prej tyre.

Për këtë arsye ajo e konsideron zgjidhjen e kontratës së punës nga punëdhënësi, për shkaqe subjektive të pabazuara në ligj, të ardhur nga fakti se ajo nuk i përket së njëjtës forcë politike si drejtuesit e KESH sh.a. Subjekti ankues pretendon se shkak i largimit të saj nga puna është në shkelje flagrante të së drejtës për punë dhe e KESH sh.a e ka diskriminuar për shkak të gjendjes arsimore, për shkak të bindjeve politike dhe të lidhjes së saj familjare me një ish-funksionar të lartë të shtetit (si bashkëshortja e tij).

Në përfundim, znj.G kërkon nga Komisioneri të konstatojë diskriminimin ndaj saj për shkaqet sipërcituar, në procedurat e kundraligjshme të largimit nga puna, nga ana e KESH sh.a. Po ashtu, ankuesja kërkon nga Komisioneri të urdhërojë KESH sh.a për ndreqjen e pasojave të diskriminimit ndaj saj duke e rikthyer në pozicionin e mëparshëm të punës; si dhe të dëmshpërblehet sipas ligjit për diskriminimin.

Ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, ofron mbrojtje nga diskriminimi. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.*

Bazuar në deklaratimet dhe në parashtrimet e depozituara nga subjekti ankues pranë Zyrës së KMD-së, Komisioneri, konstaton se:

- Me shkresën me nr.8859 prot., datë 12.10.2015 KESH sh.a ka bërë *“Njoftimin mbi fillimin e bisedimeve për zgjidhjen e kontratës së punës”*.
- Me datë 14.10.2015 ankuesja ka marrë dijeni për shkresën, gjë që e ka deklaruar vetë në ankesën e saj pranë Komisionerit.
- Me shkresën me nr.8859/3 prot., **datë 19.11.2015 KESH sh. a i ka komunikuar *“Vendimin përfundimtar për zgjidhjen e kontratës së punës” duke e njoftuar për zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme*** si dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare me datë 01.03.2016.
- Pra, *subjekti ankues ka marrë dijeni për këtë fakt, (për të cilin dhe pretendon diskriminimin), që më datë 19.11.2015, ndërkohë që ankesën e ka paraqitur pranë Zyrës*

së **Komisionerit më datë 19.12.2017**⁵, pra më vonë se një vit nga marrja dijani; konkretisht më shumë se 2 (dy) vite.

Për sa më sipër, referuar nenin 33, pika 4, germa dh), të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili citon se “*Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose një vit nga marrja dijani nga i dëmtuari, për këtë fakt*”, ankesa e znj.G, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë së janë tejkaluara afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Sa më sipër, sjellim në vëmendje se ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 34, në pikën 2 të tij, parashikon se: ...“*Paraqitja e ankimit përpara Komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t’i drejtohet gjykatës...*”.

Nga ana tjetër, ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 36, pika 1 të tij, parashikon se: ...“*Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34⁶ të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita kur ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita kur i dëmtuari merr dijani për këtë sjellje*”.

Duke qenë se ankuesja është brenda afateve të parashikuara në këtë Ligj⁷, për të ndjekur gjyqësisht pretendimin e saj për diskriminim, Komisioneri i rekomandon që t’i drejtohet gjykatës kompetente.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, pika 4/dh, nenin 33, pika 10, nenin 36, pika 1, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

⁵ Data e regjistrimit të ankesës pranë KMD-së.

⁶ Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëmshpërblim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimin përpara organeve kompetente për ndjekje penale.

⁷ Neni 36 i Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”: “Procedura para gjykatës”.

VENDOSI:

1. Mospranimin e ankesës për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

Fusha: Punësim

Shkaku: Bindje politike, gjendje arsimore